



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 206, Datë 10.08.2022

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 116, DATË 24.05.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “BLUE 1” ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2022 mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/1-1prot., datë 05.08.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin nr. 116, datë 24.05.2022 mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 116, datë 24.05.2022, licencoi shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW. Në pikën 2 të këtij vendimi, është përcaktuar detyrimi që shoqëria të depozitojë në ERE Certifikatat e Regjistrimit të Pronësisë për pasuritë me nr. 535/3, nr. 622 dhe nr. 537, përpara vënies në operim të veprës.
- Me shkresën nr. 123/15 prot., datë 30.05.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 123/16, datë 06.07.2022, shoqëria ka depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimitnr. 116/2022.
- Me plotësimin e kushtit, pika 2 dhe 4 e vendimit nr. 116/2022 shfuqizohen.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe 4 të vendimit nr. 116, datë 24.05.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**